



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 15

Prishtinë, më 29 Korrik 2011, në orën 12: 00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT TË SHËNDETËSISË, TË PUNËS
DHE TË MIRËQENIES SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Flora Brovina, Salihe Mustafa, Bahri Thaçi , Gëzim Kelmendi dhe Aurora Bakalli.

Munguan: Sasha Gjokiq dhe Nazane Breca.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj - administratore e Komisionit, Enis Halimi – zyrtar i fushës për shëndetësi, Driton Selmani –KDI, Lejla Selimi -OSBE .

Mbledhjen e kryesoi: Fikrim Damka, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 20.07.2011

3. Shqyrtimi i Projektligji për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre

4. Të ndryshme

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 20. 07. 2011

Kryesuesi konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së 20 korrikut 2011.

3. Shqyrtimi i Projektligji për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre

Fikrim Damka - Tha se para se të shkojmë në pushime, ta formojmë grupin punues i cili do të bëjë amendamentimin e këtij projektligji, në mënyrë që pas përfundimit të pushimeve ta procedojmë menjëherë Projektligjin.

Flora Brovina – Tha se Projektligji nuk është i përkryer dhe ka të meta, por pasi është një projektligj i rëndësishëm, ne duhet të bëjmë përpjekje që Projektligjin sa më shpejt ta procedojmë për miratim dhe ta përshtatim edhe me mundësit buxhetore të Kosovës. Grupi punues duhet të ketë kontakte të shpeshta me shoqatat e veteranëve të UÇK-së.

Time Kadrijaj – Tha se Projektligjin në mandatin e kaluar e kanë shqyrtuar dy komisione bashkërisht, tani a do ta shqyrtojnë dy komision të përbashkët apo do ta shqyrton vetëm ky komision? Gjithashtu shprehu gatishmërinë që të jetë pjesë e grupit punues.

Salihe Mustafa – Tha se anëtarët e grupit punues do ta bëjnë një plan të detajuar lidhur me shqyrtimin e këtij Projektligji dhe pastaj ta fillojmë amendamentimin.

Bahri Thaçi – Propozoj që përfaqësimi dhe kryesimi i grupeve punuese të bëhet sipas rregullave dhe fuqisë politike të përfaqësuar në Kuvend. Ky ligj është shumë i rëndësishëm dhe pas diskutimit në seancë edhe të kryeministrit u pa se ekziston vullneti që për shqyrtimin e këtij Projektligji të ketë një bashkëpunim dhe një mirëkuptim në mes të gjitha partive që janë të përfaqësuara në Kuvend.

Pas diskutimeve Komisioni formoi grupin punues në këtë përbërje: Flora Brovina – kryesuese, Salihe Mustafa, Time Kadrijaj, Bahri Thaçi, Aurora Bakalli dhe Gëzim Kelmendi – anëtar.

4. Të ndryshme

Fikrim Damka – Tha se nga MPMS, kemi kërkuar raport për përmbushjen e pikave të planit të PVPE, por nga ministria nuk kemi pranuar këtë raport të kërkuar.

Për pikën të ndryshme, u propozua që pas pushimeve të rishqyrtohet dhe plotësohet plani i punës së Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:40.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka